

Titulli i lëndës: Gjeovizualizimi

| Informatat themelore për lëndën | |
|--|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Ndërtimtarisë |
| Titulli i lëndës: | Gjeovizualizimi |
| Niveli: | Master i Gjeodezisë |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti i I-rë; Semestri i I-rë |
| Numri i orëve në javë: | 2+2 |
| Kreditë ECTS: | 6 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit të shpallur |
| Mësimdhënësi: | Prof.Asoc.Dr. Bashkim Idrizi |
| Të dhënat kontaktuese: | bashkim.idrizi@uni-pr.edu bashkim.idrizi@yahoo.com +383 45 341098 +389 75 712998 (viber) |
| Përshkrimi i lëndës: | Gjeovizualizimi është i orientuar kryesisht në simbolet topografike dhe variablat grafike: madhësia, ngjyrat, toponimet, orientimi, modelet; dizajnimi i hartave topografike dhe tematike dhe simbolika e tyre; dizajnimi i hartave për prezantime të ndryshme, sintezat, analiza dhe eksplorimi i të dhënave hapësinore; komentimi i të dhënave hapësinore, analiza e teknikave për të dhënat grafike; 2D; 2.5D, 3D dhe 4D grafikë dhe prezantime; modelet virtual; Hartografia në internet; alternativat për publikim online të atlaveve elektronike; programimi dhe automatizmi në vizualizim. |
| Qëllimet e lëndës: | Objektivat themelore e kësaj lënde janë mësimi i parimeve hartografike dhe teknikat për vizualizim efektiv të të dhënave hapësinore. Me përfundimin e këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të modelojnë prodhime hartografike analoge dhe digjitale duke shfrytëzuar sistemet ekzistuese bazuar në SIGJ, si dhe do të arrijnë nivel të lartë në të menduarit kritik si element esencial në krijimin e produkteve hartografike. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">- Të kenë njohuri për simbolet hartografike dhe klasifikimin/kategorizimin e të dhënave,- Njohje dhe përdorim i variablave vizuale: hapësirë, madhësi, orientim, formë, strukturim, lartësi, hijezim, shkallëzim,- Simbolet në modelimin e hartave topografike dhe tematike,- Dizajnimi i hartave për prezantime, sintezat, analiza |

| | |
|--|--|
| | dhe eksplorimi i të dhënave hapësinore, - Teknikat për analizë të të dhënave grafike. |
| Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës | Paraqitja e simbolizuar estetike dhe funksionale e të dhënave gjeohapësinore, në hartat elektronike bazuar në teknologjinë ueb, desktop dhe mobil. Lënda është bashkëkohore dhe bazike për nivelin master të gjeodezisë. |

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|--|--------------|-----------|------------|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | 4 | 4 | 16 |
| Përgatitje për test intermediar | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | 4 | 4 | 16 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 1 | 10 | 10 |
| Përgatitja për provimin final | 2 | 10 | 20 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 6 | 4 | 24 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 2 | 2 | 4 |
| Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë... | | | |
| Total | | | 150 |

| | |
|--------------------------------|--|
| Metodat e mësimdhënies: | - <i>Ligjëratë</i> - <i>Diskutime gjatë ligjëratave.</i> - <i>Ushtrime</i> - <i>Punë në grupe.</i> |
| Metodat e vlerësimit: | Parakusht për hyrje në provim: pjesëmarrje mbi 50% në ligjëratat dhe punimet e pranuar nga mësimdhënësi. Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 30% Vijimi i rregullt: 10% Provimi final: 30% Total: 100% |
| Literatura primare: | 1. Terry, B. Robert, Thematic Cartography and Geovisualization, 3rd edition, 2009 2. M.-J. Kraak & F. Ormeling, Cartography – Visualization of Geospatial Data, Prentice Hall, 2nd edition, 2003 3. Nollenburg M. Geographic geovizualization, |
| Literatura shtesë: | 1. D. Jason, A. Maceachren, M. Jan Krak: Exploring Geovisualization, 2005 |

| | |
|--|---|
| | <p>2. Idrizi B.: Hartografia e përgjithshme dhe përgjithësimi hartografik. 2006.</p> <p>3. Terry A. Slocum, Connie Blok, Bin Jiang, Alexandra Koussoulakou, Daniel R. Montello, Sven Fuhrmann, and Nicholas R. Hedley. Cognitive and Usability issues in Geovisualization. 2001.</p> <p>4. Idrizi B., Hartografia Topografike. 2021.</p> <p>5. AKK. Nomenklatura, simbolet, shenjat dhe pozicionimi i hartës topografike 1:25000. 2016.</p> |
|--|---|

| Hartimi i planit mësimor | |
|---------------------------------|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | Hyrje në hartografi dhe gjeovizualizim |
| Java 2: | Konceptet themelore të gjeovizualizimit |
| Java 3: | Variablat grafike |
| Java 4: | Simbolet topografike |
| Java 5: | Klasifikimi i të dhënave |
| Java 6: | Hartat e shumëllojshme |
| Java 7: | Hartat topografike dhe tematike |
| Java 8: | Vlerësimi i parë intermediar Punimi i kolokiumit të parë kualifikues |
| Java 9: | Dizajnimi i hartave topografike dhe tematike |
| Java 10: | Dizajnimi i produkteve hartografike manuale dhe digjitale. |
| Java 11: | Analiza dhe eksplorimi i të dhënave hapësinore |
| Java 12: | Teknikat analizë të të dhënave grafike |
| Java 13: | Publikimi online |
| Java 14: | Prezentimi i projektit. |
| Java 15: | Vlerësimi i dytë intermediar Punimi i kolokiumit të dytë kualifikues |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
|---|
| <p><i>Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.</i></p> <p><i>Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.</i></p> <p><i>Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.</i></p> <p><i>Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.</i></p> |

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.